

Efektet e Pokemon Go janë njësoj si të një droge

19 Gsh

Thelbi i Pokemon Go është ai i transferimit nga një realitet konkret ne një realitet virtual. Efekti madje është edhe me i forte se ai i pijeve alkoolike dhe drogave, rrjedhimisht shume i rrezikshëm.



Ne këtë përfundim ka dale Margherita Spagnuolo Lobb, kërkuese ne Gestalt HCC Institute. Psikoterapeutja e njohur heq një paralele mes kësaj loje te re dhe një droge te njohur me se shumti gjate viteve '70, Lysergic acid diethylamide (Lcd). Ne këtë periudhe, përdorimi i kësaj substance stimulohej mbi bazën e një ideje qe e konsideronte atë si një mënyrë për te zhvilluar fuqitë e njeriut. Megjithatë, ka një diference, pasi nëse ne vitet 70', kjo praktike alucinante konsumohej ne grup, ne lojën e Pokemon ajo mbetet një eksperience tërësisht personale. I zhytur ne këtë realitet virtual, lojtari i Pokemon nuk ka pranë asnjë person tjetër qe te mund ta mbroje dhe shpëtojë nga rreziqet dhe te papriturat e botes reale. Dallimi tjetër është se rrezikshmëria e kësaj loje, ndryshe nga ajo e Lcd, e cila vepronte ne nivel biologjik, vepron ne nivel social. Lojtaret e kësaj loje nuk dobësohen për efekt te substancave psikotrope, por ata nuk posedojnë me aftësinë për te kuptuar limitet reale te kontekstit ne te cilën përfshihen gjate lojës.

FACEBOOK



SONDAZH

Një personazh i njohur, komentoi keq lidhjen e Marinës me Getoarin
(Ju si mendoni?)

- Ka të drejtë
 Ka gabuar

Voto